



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:044853

Datë: 02.10.2018

Numri i dokumentit: 00148533

P. nr.915/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.M.nga fsh.G.K.Gj., për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi, nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.1668/2017 të datës 12.12.2017, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datën **02.10.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit me mbrojtësin e tij Av.P. P., të dëmtuarit Përfaqësuesit të autorizuar i K.-Gjakovë, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S.M.**, i biri i S., i nënës F., e gjinisë H., data e lindjes..., në fsh.G. K. Gj., ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar- atë i 6 fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK-ës:

REFUZOHET AKUZA

Sepse; 1.Nga data e pavëretetuar e gjer me dt.02.06.2015 në restorantin e tij “K.” e cila gjendet në fsh.G. komuna e Gj., me qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshëm, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr.40... përmes kabllos është lidhur direkt në rrjetin elektrik ashtu që ka pamundësuar kështu regjistrimin e saktë të energjisë elektrike t shpenzuar, me ç’ rast ndërmarrjes së dëmtuar K-Divizioni Gj. i ka shkaktuar dëme në shumën prej 143.14 euro.

2.Nga data e pavërtetuar e gjer me dt.10.11.2016 në restorantin e tij “K.” e cila gjendet në fsh.Gë. komuna e Gj., me qëllim që vetëm ti sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshëm, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik të kundërligjshëm, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me

nr.40... përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik ashtu që ka pamundësuar kështu regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar K.-Divizioni G. i ka shkaktuar dëme në shumën prej 5035.85 euro.

-me çka do të kishte kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi, nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës.

E dëmtuara K.-D. i rrjetit D. në Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzë PP.nr.1668/2017 të datës 12.12.2017, kundër të akuzuarit S. M. nga fsh.G., për shkak të veprës penale, shfrytëzimi i pa autorizuar i energjisë elektrike në vazhdimsi nga neni 61 par.1 pika 1 pika 1.1 të Ligjit 05/L-085 të Ligjit për Energji elektrike, lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj pasi lexoi aktakuzën bënë rikualifikimin e veprës penale ashtu që në vend të veprës penale në vazhdim shfrytëzim i pa autorizuar i energjisë elektrike nga neni 61 par.1 pika 1.1 të Ligjit 05/L-085 të Ligjit për energji elektrike lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duhet të jetë vepra penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi, nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Në shqyrtimin fillestar të dt.30.05.2018 i akuzuari S. M. deklaroi se nuk e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, sepse këtë njehsor elektrik nuk e shfrytëzoi unë respektivisht nuk jam pronar i restorantit "K." unë punoi në botën e jashtme, por pronar i restorantit "K." dhe shfrytëzues i këtij njehsori elektrik është vëllau im B. M..

Në shqyrtimin gjyqësor të dt.16.08.2018, në procedurën e provave është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit B. M., i cili deklaroi se është pronar i restorantit "K." në fshatin G. K.Gj., si dhe është shfrytëzues i njësorit elektrik që është e cekur në dispozitivin e aktakuzës.

Në shqyrtimin gjyqësor të dt.02.10.2018 mbrojtësi i të akuzuarit S. M. av.P.P. prezantoi si provë Gjykatës Certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr.70... në emër të D.P.H."K." pronar i së cilës është B. M..

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu deklaroi se pasi shqyrtova deklaratën e dëshmitarit B. M. si dhe shkresat tjera në lëndë, e sidomos pas provës të prezentuar nga mbrojtësi i të akuzuarit av.P.P. certifikatën e biznesit me të cilën vërtetohet se pronar i këtij lokali është B. M., andaj tërhiqem nga dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar në aktakuzë si personat e autorizuar të K.-it A. A., F. Ç. dhe A. G., për shkak se u vërtetua një gjendje tjetër faktike se i akuzuari S. M., nuk është pronar i këtij objektit, i njëjti punon në botën e jashtme që nga viti 1...., prandaj i njëjti nuk është shfrytëzues i këtij njehsori elektrik, sepse të njëjtit e kanë të ndarë bashkësinë familjare dhe me këtë biznes mirret vëllau i tij por njehsori ende figuron në emrin e tij, sipas deklaratës së dëshmitarit tërhiqem nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit S. M.,

për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi, nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, në mungesë të provave, ndërsa e dëmtuara do të paraqet kallëzim të rij penal ndaj B.M. si shfrytëzues dhe pronar i këtij lokali.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës K. në Gj., L. M. deklaron, se duke qenë se prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit S. M., si palë e dëmtuar do të ushtrojmë kallëzim të rij penal ndaj B.M. si kryes i kësaj veprë penale.

Pasi që Prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit S.M., për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi, nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Gjykata në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK-ës, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.3 të KPPK-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri në mbështetje të nenit 454 par.1 të KPPK-ës.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.915/17 më datë 02.10.2018.**

**Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese
Diana Sina**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:044853
Datë: 02.10.2018
Numri i dokumentit: 00148533